



Vendimi Nr.43/24  
Datë: 29.04.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023, Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 29.04.2024, mori këtë:

## V E N D I M

- I. LEJOHET Përqendrimi i ndërmarrjeve, lidhur me blerjen e 100% të aksioneve URC Systems, spol. s.r.o (URC) (targeti) nga Piombino Group a.s. (Piombino) (blerësi).
- II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguajë taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (një mijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, nën paragrafi 1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 i Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

## Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë: 13.03.2024, me Nr. Prot. 153/24-11/H dhe plotësimin të kërkesës së datës: 18.03.2024, me Nr. Prot. 174/24-11/H, ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit, lidhur lidhur me blerjen e 100% të aksioneve URC Systems, spol. s.r.o (URC) nga Piombino Group a.s. (Piombino).

## Procedurat e ndjekura

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë: 28.03.2024;
2. Njoftimi për realizimin e përqendrimit, në web faqen e AKRK-së me datë: 29.03.2024;
3. Palët në Përqendrim kanë lidhur Marrëveshje për Blerjen e Aksioneve, të nënshkruar më 7 Mars 2024.

## **Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit**

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtar e kalon shumën 20,000,000 Euro;
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro;
3. Palët kanë lidhur Marrëveshjen për Blerjen e Aksioneve, të nënshkruar më 7 Mars 2024.

Piombino Group a.s, është shoqëri aksionare me seli në Generála Píky 430/26, Dejvice, 16000, Pragë 6, Çeki. Me numër të biznesit, 14432838. Piombino është një kompani që i përket Grupit JH, e kontrolluar përfundimisht vetëm nga z. Jakub Havralnt (JH), (“Grupi JH”), respektivisht një SPV, pa ndonjë aktivitet biznesi (blerësi).

Pjesë kryesore e Grupit JH, është grupi i biznesit dhe investimeve Rockaway (“Rockaway Group”). Aktivitetet e Rockaway group janë të fokusuara kryesisht në tregtinë elektronike, udhëtimin elektronik, teknologjitë financiare, botimin e mediave dhe librave, shitjen me shumicë dhe pakicë, kapitalin sipërmarrës e real dhe investimet për zhvillimin e pasurive. Rockaway Group është aktiv në Kosovë përmes subjektit, Gjirafa Group, e cila operon në Kosovë si një motor kërkimi në gjuhën shqipe, një platformë marketingu online dhe një platformë e-commerce.

URC Systems, spol., s.r.o, me seli në Vrahovická 825/156b, Vrahovice, 79822 Prostejov, Çeki, me numër të biznesit, 25547526. URC është aktive në kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e pajisjeve teknike ushtarake dhe të mbrojtjes, veçanërisht në fushat e sistemeve të zbulimit dhe bllokimit, zbulimit dhe vëzhgimit të radios, bllokimit të radios, automjeteve tokësore pa pilot, qendrave dhe sistemeve të monitorimit të sigurisë. Në lidhje me produktet në këto fusha, URC ofron gjithashtu shërbime trajnimi, edukimi, shërbimi dhe mirëmbajtjeje (targeti).

**Tregu i produktit**, Tregu i kërkimit, zhvillimit dhe prodhimit të paisjeve teknike ushtarake dhe të mbrojtjes.

**Tregu gjeografik**, Tregu përkatës gjeografik, bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.01/2023, tregu gjeografik do të jetë tregu që përfshinë zonën në të cilën ndërmarrjet përkatëse përfshihen në furnizimin dhe kërkesën e mallrave ose shërbimeve, në të cilën kushtet e konkurrencës janë homogjene dhe mund të dallohen nga kushtet në zonat fqinjë. Në këtë rast, tregu gjeografik mund të lihet i hapur.

## **Analiza e konkurrencës**

Transaksioni i propozuar nuk ngritë ndonjë shqetësim për konkurrencën në tregun përkatës të Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh që transaksioni nuk rezulton në asnjë mbivendosje horizontale ndërmjet palëve në tregun e ngushtë në Kosovë, për arsye se Piombino nuk ofron shërbime të prodhimit të paisjeve ushtarake në Kosovë, që domethënë se palët nuk veprojnë në treg të njëjtë të produktit. Piombino nuk ka ndonjë aktivitet të vet biznesi. Transaksioni nuk çon në ndonjë mbivendosje horizontale ose marrëdhënie vertikale në aktivitetet e palëve dhe në këtë mënyrë, çdo shqetësim i mundshëm i konkurrencës mund të përjashtohet qartë. Çështja e përcaktimit të saktë të tregut gjeografik, mund të lihet e hapur.

### **Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar**

Transaksioni kryesisht do të zhvillohet në tregun e Republikës Çeke. Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë, për arsye se Rockaway Group është pjesë e JH Grup dhe është aktiv në Kosovë përmes subjektit, Gjirafa Group, e cila operon në Kosovë si një motor kërkimi në gjuhën shqipe, një platformë marketingu online dhe një platformë e-commerce.

Grupi Gjirafa ka këto filiale në Kosovë:

- Gjirafa Kosovë L.L.C, me numër identifikues: 810123860;
- Gjirafa, Inc-Dega në Kosovë, me numër identifikues: 810840307;
- Trekandi SH.P.K., me numër identifikues 810046757 dhe
- Carvago by Gjirafa L.L.C, me numër identifikues: 812112887.

Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës, për arsye se Piombino dhe URC Systems nuk janë fare prezente në Kosovë. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk do të ketë efekt negativ në tregun kosovar, e rrjedhimisht nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në tregun përkatës. Divizioni i Përqendrimeve ka vlerësuar se ky transaksion, nuk do të paraqesë efekte negative në konkurrencë, për arsye se ky transaksion/blerja nuk do të ndikojë në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse tek operatorët ekonomik apo konsumatorët, përkatësisht objekti i kontratës nuk korrespondon, me tregun përkatës të Republikës së Kosovës.

### **Shënim:**

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurrese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij, Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë.